

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Klinë duke vendosur në procedurën e kundërvajtjes ndaj të pandehurës **Shukrije Shala nga Klinë**, për kundërvajtje nga nenet 5,6 paragrafi 1.3.neni 9 dhe 17 al. 1.3 të Ligjit për deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, konform neneve 30,73,74,123,195 dhe 135 al.2. të Ligjit mbi kundërvajtjet me datën 24.12.2012 bie këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË Kërkesa e Kundërvajtës e parashtruar nga Agjencia Kundër Korrupsionit nr.01-2175/12 e datës 15.06.2012 e parashtruar ndaj **Shukrije Shala e lindur me 01.09.1963 në Klinë**, i paraqitur për kundërvajtje nga nenet 5,6 paragrafi 1.3 neni 9 dhe 17 al.1.3 të Ligjit për deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, e konform nenit 135 al.2 të Ligjit mbi Kundërvajtje.

Me një kopje të aktvendimit të njoftohet parashtruesi i kërkesës.

A r s y e t i m

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT- Prishtinë. ka parashtruar kërkesë për fillimin e procedurës së kundërvajtjes nr. 01-2175/12 të datës 15.06.2012 ndaj të sipër cekurit për kundërvajtje nga nenet 5,6 paragrafi 1.3 neni 9 dhe 17.al 1.3 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Gjykata me datë 30.09.2012 ka kërkuar nga Agjencia kundër korrupsionit respektivisht parashtruesi i kërkesës konform nenit 135 al.2. të Ligjit mbi kundërvajtje të benë **plotësimin e kërkesës së kundërvajtjes** me nr. dhe date të sipër cekur, me vërejtje se nëse ne afat prej 15 ditësh nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës (neni 135 al.3. të Ligjit mbi kundërvajtje) kërkesa për zhvillimin e procedurës kundërvajtës si e tillë do të **huhët poshtë** me aktvendim konform nenit 135 al.2 të Ligjit mbi kundërvajtjet.(kështu është e rregulluar me Ligj).

Parashtruesi i kërkesës së kundërvajtjes ,kërkesën e gjykatës për plotësim kërkesë e ka pranuar, nuk e ka plotësuar brenda afatit të paraparë me Ligj e as në një afat optimal, është kthyer si e plotësuar pa e plotësuar fare andaj, konsiderojmë se ka **hequr dorë** nga kërkesa .


Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

U vendos në Gjykatën Komunale për kundërvajtje në Klinë, me datën 24.12.2012 vjet. Regj.nr.4097/12

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA ANTICORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
DPK/DMP	Nr. Prot. 03-4650/12
02	Data 28.12.2012

03-4650/12/02
sluq.

UDHËZIM JURUDIK: Kundër këtij Aktvendimi ka të drejt ankese parashtruesi i kërkesës së kundërvajtjes, në Gjykatën e lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të Aktvendimit nëpërmes kësaj Gjykate.



**Gjyqtari
Kadri Prekaj**